



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT
TIRANË

Nr. Regj. Them. 12808/9966/5442/1368/89 (31025-06823-86-2015) Nr. vendimi 1100 (86-2019-1251)
Data e regjistrimit 12.11.2015 Data e vendimit 09.04.2019

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata Administrative e Apelit, e formuar si trup gjykues, në përputhje me parashikimet e nenit 12, pika 2, shkronja “a”, të ligjit Nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (ligji Nr. 49/2012), nga gjyqtarët:

Amarildo	LAÇI	KRYESUES
Alkelina	GAZIDEDJA	ANËTARE
Bari	SHYTI	ANËTAR

Asistuar nga sekretarja gjyqësore, [REDAKTUAR] në Tiranë, sot në datë 09.04.2019, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit Nr. 49/2012, çështjen me Nr. 12808/9966/5442/1368/89 (31025-06823-86-2015) akti, datë 12.11.2015, që iu përket:

PADITËSE:

[REDAKTUAR] e bija e [REDAKTUAR] banuese në Tiranë, në adresën: Rruga [REDAKTUAR], pallati [REDAKTUAR], Tiranë, e përfaqësuar nga av. [REDAKTUAR]

TË PADITUR:

1.-Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Tiranë, e përfaqësuar nga *juristja* [REDAKTUAR]

2.-Drejtoria Rajonale Tatimore, Tiranë, në mungesë.

Me pjesëmarrjen e Avokatit të Shtetit pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, znj. [REDAKTUAR]

PALË E TRETË:

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Tiranë, në mungesë.

OBJEKTI:

-Detyrimin e palës së paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore, Tiranë, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të shpërblejnë në mënyrë solidare dëmin pasuror në favor të Kozeta Tilit, të shkaktuar nga diskriminimi shëndetësor dhe largimi nga puna, duke ardhur pasoja e dëmtimin e shëndetit

dhe përkeqësimit nga ndërhyrja kirurgjikale, në masën 1,000,000 lekë.

-Detyrimin e palës së paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore, Tiranë, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të shpërblejnë në mënyrë solidarë dëmin jopasuror në favor të [REDAKTUAR] të shkaktuar nga diskriminimi shëndetësor dhe largimi nga puna e datës 03.07.2014, me pasoje dëmtimin e shëndetit në masën 2,000,000 lekë, e ndarë si me poshtë: Shpërblimi për dëmin biologjik në vlerën 1,000,000 lekë, shpërblimi për dëmin moral në vlerën 500,000 lekë, shpërblimi për dëmin ekzistencial në vlerën 500,000 lekë.

BAZA LIGJORE:

Nenet 18 dhe 49 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Neni 14 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; Nenet 32/a, 154, të Kodit të Procedurës Civile; Ligji nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”; nenet 3, 7, 12, 13, 34, 36, 37, 38 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”; Nenet 450, 608, 609, 618, 620, 625/a, 640 e vijues të Kodit Civil; Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”; Vendimi Unifikues nr. 12, datë 14.09.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, me vendimin Nr. 4501 (80-2015-2791), datë 17.09.2014 ka vendosur:

- Pranimin e kërkesëpadisë.
- Detyrimin solidar të palës së paditur, Drejtoria Rajonale e Tatimeve, Tiranë, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, t’i shpërblejnë paditëses vlerën e dëmit si vijon, dëm moral 250,000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë dhe dëm ekzistencial 250,000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë.
- Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës paditur.
- Ky vendim përbën titull ekzekutiv, sapo të marrë formë të prerë dhe ekzekutohet në mënyrë vullnetare ose të detyruar nga shërbimi përmbarimor gjyqësor.
- Ekzekutimi i këtij vendimi do të bëhet në një kësht të vetëm brenda një viti kalendarik nga momenti që vendimi merr formë të prerë.
- Kundër vendimit mund të bëhet ankim brenda 15 ditëve nga e nesërmja e shpalljes, në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë. Për palët në mungesë afati ankimit fillon nga e nesërmja e njoftimit të vendimit.
- Një kopje e vendimit t’i njoftohet palës paditëse dhe të paditur DPT Tiranë.

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim me datë 13.10.2015, paditësja [REDAKTUAR] (pas plotësimit të të metave të tij), duke parashtruar këto shkaqe, për ndryshimin e vendimit Nr. 4501 (80-2015-2791), datë 17.09.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, dhe pranimin e plotë të padisë:

- Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 e 11 të Kodit të Procedurës Civile. Gjatë gjykimit janë marrë prova me ekspert, për

vlerësimin e dëmit dhe gjykata nuk i është referuar vlerësimin të aktit në themel, por vetëm në vlerën e llogaritjes.

- Gjykata, në vlerësimin e saj, megjithëse pranon se ekziston faj i provuar me vendimin e Komisionerit të Mbrojtjes nga Diskriminimi, në vendimin e saj eliminon ose pakëson pasojën e ardhur nga konsumimi i fajit.
- Pretendohet se konsumimi i fajit nuk ka shkaktuar vetëm dy lloj dëmsh. Vlerën e dëmeve për çdo fazë, si gjatë marrëdhënieve të punës dhe pas marrëdhënieve të punës, e kemi pretenduar dhe ekspertit i thirrur dhe caktuar nga gjykata e ka llogaritur dëmin e shkaktuar.
- Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, nuk pranon se ka dëm pasuror me pretendimin se dëmi pasuror është vetëm kur humbet pasuria. Konkretisht pretendon se nuk ka ardhur dëm pasuror. Argumenti i saj është se sëmundja ka filluar më përpara se të vijë diskriminimi. Ky argument nuk do të thotë se nuk ka dëm pasuror.
- Ky pretendim nuk qëndron, sepse pasuria konsiderohet e humbur dhe kur je i detyruar të harxhohen të ardhurat pasurore për arsye shëndetësore dhe ne kërkojmë rikthimin e dëmit që ka ardhur nga shpenzimet për kurimin e shëndetit në momentin që ka filluar diskriminimi e në vazhdim.
- Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, arsyeton se, dëmi pasuror nuk është i provuar. Ky arsyetim nuk qëndron, sepse unë paditësja e kam vendosur një vlerë të dëmit pasuror që ka ardhur për efekt të rëndimit të gjendjes shëndetësore pas fillimit të diskriminimit dhe kjo vlerë nuk është dhënë si detyrë ekspertit për të llogaritur këtë dëm. Për rrjedhojë ajo vlerë konsiderohet e mirëqenë.
- Gjykata, ka neglizhuar llogaritjen e llojeve të dëmeve të shkaktuara dhe të përcaktuar si në objektin e kërkesëpadisë dhe në arsyetimin e pretendimet e ngritura. Po kështu ka vepruar dhe ekspertit.
- Ankuesja pretendon se nga ana e saj është shteruar rekursin administrativ duke iu drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve si organi më i lartë administrativ, ku më është kthyer përgjigje me shkresën nr. 6240/1 prot., datë 17.03.2015.
- Paditësja ka qenë në marrëdhënie pune me palën e paditur dhe me ardhjen e drejtuesve të rinj ka filluar ecuria disiplinore, kur nuk ekzistonte thyerja e disiplinës. Mbi ecurinë disiplinore tendencioze nga ana e palës së paditur është ushtruar ankim pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili ka kryer hetimin administrativ mbi diskriminimin shëndetësor që ka ardhur nga pala e paditur, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë. Në përfundim të hetimit, Komisioneri ka disponuar me vendimin nr. 11, datë 23.01.2015, me të cilën ka vendosur: *"Konstatimin e mosdiskriminimit për shkak të bindjeve politike, të znj. [REDAKTUAR] nga ana e DRT Tiranë; Konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë, për shkak të gjendjes shëndetësore të znj. [REDAKTUAR] nga ana e DRT Tiranë."* Në referim të pikës 2 të këtij vendimi, i rekomandohet subjektit ankues që mund të kërkojë dëmshpërblim sipas parashikimeve ligjore, gjyqësish, bazuar në nenin 36, pika 1, nenin 37, pika 1, dhe në nenin 38 të ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi."
- Është i provuar diskriminimi, pra faji, ku nga ky shkak ka ardhur pasoja duke sjell dëm mbi shëndetin. Pala e tretë, Komisioneri i Mbrojtjes nga Diskriminimi, ka hetuar hollësisht dhe ka vërejtur se, duke filluar nga muaji janar 2014, me emërimin e Drejtorit të ri të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë z. [REDAKTUAR] kanë nisur dhënia e masave disiplinore të pambështetura në fakte, prova dhe në ligj. Diskriminimi ka qenë i drejtpërdrejtë, ka vazhduar me tendencë dhe presion të vazhdueshëm.

- Pas dhënies së masës së parë paditësja është paraqitur për çdo ditë në punë, por ajo isha e diskriminuar, sepse paditëses nuk i jepej asnjë punë konkrete sipas detyrës që ishte e emëruar dhe kishte kryer në vazhdimësi.
- Në piken 2 të nenit 2 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” është cilësuar: “Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër - personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.”
- Paditësja pretendon se nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë, nuk është pajisur me kartën ligjore (Badge), për vitin 2014 kur të gjithë të tjerët ishin pajisur rregullisht. Nga Komisioni Disiplinor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Tiranë, është marrë vendimi me datë 26/02/2014, për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me shkrim”. Më vonë ka vazhduar përshkallëzimi i masave disiplinore me datë 23/05/2014 dhe e fundit duke më larguar nga shërbimi civil dhe nga detyra me vendimin 1068, datë 26/06/2014, të Komisionit Disiplinor të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.
- Faji është i provuar se është shkaktuar dëm nga pala e paditur Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë. Dëm ka shkaktuar dhe pala e paditur Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë, e cila ka miratuar të gjitha veprimet e palës së paditur Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë.
- Bazuar në ligjin nr. 8510, datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”, është kërkuar që institucioni administrativ në lidhje me vendimin për masat disiplinore dhe largimin nga shërbimin civil të dëmshpërblehem në mënyrë solidare.
- Këto veprime dhe mosveprime të palës së paditur Drejtoria Rajonale të Tatimeve Tiranë, të Komisionit Disiplinor të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, kanë shkaktuar dëm të rëndë mbi shëndetin e paditëses, duke përkeqësuar situatën e rëndë shëndetësore që po kaloja. Paditësja është trajtuar dhe diagnostikuar përpara kësaj periudhe më 29.02.2012 me kancer. Në periudhën që pala e paditur po procedonte me dhënien e masës disiplinore dhe largimin nga shërbimi civil të punonjëses, ajo ka qenë me raport mjekësor dhe e shtruar në spital, për trajtim të një shtetërore të vështirë shëndetësore. Kjo e provuar sepse raportit mjekësor për periudhën 27.05.2014 deri me datë 10.07.2014.
- Këto veprime kanë cenuar rëndë shëndetin dhe personalitetin në aspektin pasuror dhe jopasuror. Për të baraspeshuar dëmin e shkaktuar pretendohet që të zhdëmtohem sipas sasisë të hollave të kërkuara në objektin e kërkesë se padisë. Dëmi është akoma më i madh, sepse pasojat e shëndetit pothuajse janë të pariparueshme, por ato rëndohen për çdo ditë kur paditësja ndjehet e braktisur. Paditësja vazhdon të kurohet dhe familjarët janë në përkujdesje të vazhdueshme dhe të traumatizuara nga këto veprime të palës së paditur.
- Pretendohet se ekziston faji, gjithashtu është e provuar se ekziston dëmi pasuror dhe jopasuror, sipas kërkesave të ligjit nr. 8510, datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”, dhe Kodit Civil. Me zhdëmtimin e dëmi në masën e kërkuar nuk eliminohen plotësisht pasojat e krijuara, por ky kërkim është kryer duke vlerësuar kushtet ekonomike të vendit. Dëmi për shëndetin nuk ka çmim dhe duhej të ndalohej diskriminimi nga pala e paditur. Por diskriminimi vazhdon në mënyrë permanente, pa pranuar rikuperimin të paktën me rikthimin në punë.

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim, në datë 01.10.2015, pala e paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore, Tiranë, duke parashtruar këto shkaqe për ndryshimin e vendimit Nr. 4501 (80-2015-2791), datë 17.09.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, dhe rrëzimin e plotë të padisë:

- Paditësja [REDAKTUAR] ka qenë e punësuar në Drejtorinë Rajonale Tatimore, Tiranë, në pozicionin e inspektore në Drejtorinë e Verifikimit në Terren. Për shkak të shkeljeve disiplinore të konstatuara nga eprori i saj i drejtpërdrejtë, paditësja është propozuar, për masa disiplinore, duke vijuar deri në largimin e saj nga shërbimi civil me vendimin nr. 1068, datë 26.06.2014.
- Vendimin e mësipërm, Zj. [REDAKTUAR] e ka kundërshtuar në Gjykatën Administrative të Shkallës Pare, Tiranë e cila në përfundim të shqyrtimit të çështjes ka vendosur pranimin e kërkesë padisë, rikthimin e saj në vendin e punës si dhe dëmshpërblimin e saj deri në rikthim në punë. Kundër këtij vendimi pala e paditur ka ushtruar ankim përpara Gjykatës së Apelit Administrativ, vendimmarrja e të cilës do të jetë e formës së prerë çka do të thotë e detyrueshme për t'u zbatuar nga të dyja palët ndërgjyqëse në këtë proces gjyqësor.
- Zj. [REDAKTUAR] në këtë padi kërkon dhe pretendon dëmshpërblim për shkak të dëmit të madh të shkaktuar e cila konsiston në dëmin moral, dëmin biologjik dhe atë ekzistencial. Së bashku me pretendimet në lidhje me 3 llojet e dëmit të pasuara, paditësja kërkoj edhe kryerjen e aktit të ekspertimit e cila është kundërshtuar në parim, kjo pasi nuk rezultojnë provuar dëmi i pësuar. Nuk është pranuar asnjë konkluzion i arritur i aktit të ekspertimit i cili në mungesë të argumentimit me prova e fakte të dëmeve të pësuar, ka bërë një interpretim juridik e teorik të ligjit dhe të vendimeve unifikues të Gjykatës së Lartë.
- Eksperti ka nxituar për të përcaktuar shifra dhe vlera, por duhet të gjykojë mbi bazën e provave shkresore, mbi bazën e rrethanave të ndodhura dhe vetëm pasi të jetë vërtetuar katërcipërisht lidhja shkak-pasojë mund të konkludojë në masën e dëmshpërblimit për të tre kategoritë e dëmit të pretenduar.
- Paditësja pretendon se, vendimi i marrë nga Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi duke e shpallur atë si viktimë e diskriminimit shëndetësor, duhet marrë i mirëqenë dhe në mbështetje të këtij vendimi duhet të bëhen përllogaritjet përkatëse. Paditësja pretendon se sëmundja e saj ka përparuar, për shkak të fillimit të ecurisë disiplinore të filluar ndaj saj dhe kryerja e operacionit ka ardhur si shkak i rëndimit të gjendjes psikologjike për shkak të ndërprerjes të marrëdhënies të punësimit. Në lidhje me këtë pretendim pala e paditur ka cilësuar se sëmundja e Znj. [REDAKTUAR] është shfaqur përpara ecurisë disiplinore, pra ka qenë prezent në momentin e fillimit të ecurisë disiplinore. Nuk rezultojnë provuar lidhja shkak-pasojë, pra të provohej se largimi nga puna ka sjellë sëmundjen e Znj. [REDAKTUAR]
- Kuptohet që në kushtet e një sëmundshmërie, ardhja e situatave të tilla në marrëdhëniet e punës mund të rendojnë gjendjen shëndetësore, por jemi në rastin që fillimi i ecurisë disiplinore apo largimi i saj të ketë sjellë sëmundjen. Pretendohet se jo gjithmonë sëmundja është e lidhur pazgjydhshëmrisht me një shkak të caktuar që mund të jetë zgjidhja e marrëdhënies të punës.
- Eksperti i caktuar nga gjykata në përllogaritjen e dëmit i referohet praktikave të ngjashme në fushën e sigurimeve në sektorin e transportit, kjo analogji nuk mund të aplikohet për sa kohë janë fusha të ndryshme. Në lidhje me ekzistencën e dëmit moral duhet të vërtetohet se, për shkak të ecurisë disiplinore të filluar si dhe zgjidhjes së marrëdhënies të punës, të ketë ardhur turbullimi, dhimbje dhe vuajtje shpirtërore, ankth dhe mundim i madh shpirtëror. Pa diskutim që një situatë e tillë e marrëdhënies të punës shkakton

shqetësim, por nëse ky shqetësim ka çuar në ankth apo një mundim të madh shpirtëror, ketë nuk e vërteton dot eksperti i cili ka përlogaritur edhe masën e dëmshpërblimit duke mos e ditur sa është masa e ankthit të shkaktuar apo përmasa e dhimbjes shpirtërore.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT,

Si zhvilloi gjykimin e çështjes në shkallë të dytë në seancë gjyqësore publike;
përsëriti pjesërisht hetimin gjyqësor të çështjes, në konformitet me përcaktimet e nenit 465(3) të K.Pr.Civile;

dëgjoi paditësen, [REDAKTUAR] dhe përfaqësuesin e saj, av. [REDAKTUAR], që kërkuan: Ndryshimin e vendimit Nr. 4501 (80-2015-2791), datë 17.09.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, dhe pranimin e plotë të padisë;

dëgjoi përfaqësuesen e palës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe atë të Avokaturës së Shtetit, që kërkuan: Ndryshimin e vendimit Nr. 4501 (80-2015-2791), datë 17.09.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë dhe rrëzimin e padisë;

dhe e shqyrtoi çështjen brenda shkaqeve të ngritur në ankimet respektive, në përputhje me normat ligjore relevante materiale e procedurale,

V Ë R E N:

Vendimi Nr. 4501 (80-2015-2791), datë 17.09.2015, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, është rrjedhojë i zbatimit korrekt të ligjit dhe analizës së saktë e koherente të provave të marra në shqyrtimin gjyqësor, ndaj ai duhet të lihet në fuqi, në përputhje me germën “a”, të nenit 53 të ligjit nr. 49/2012.

I. Rrethanat e çështjes:

Gjatë hetimit gjyqësor të çështjes në të dy shkallët e gjykimit administrativ, kanë rezultuar të provuara këto rrethana faktike:

Paditësja, [REDAKTUAR] ka ushtruar detyrën e Inspektore Vlerësuese, në Sektorin e Kontrollit në Terren, pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë (“DRT Tiranë”). Gjatë kohëzgjatjes së marrëdhënieve të punës (01.04.2010-17.07.2014), rezulton se paditësja ka kryer detyra të ndryshme funksionale.

Ndaj paditëses, me vendimin nr. 650, datë 25.03.2014, Drejtori i Përgjithshëm ka marrë masën disiplinore “Vërejtje me shkrim”.

Pala e paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (“DPT”), me shkresën nr. 12486 Prot., datë 22.05.2014, ka filluar ecurinë disiplinore, për shkelje shumë të rënda. Komisioni Disiplinor pranë DPT-së, me vendimin Nr. 1086, datë 23.06.2014, pasi ka zhvilluar procedurën e hetimit administrativ, ka arritur në përfundimin se, paditësja, Kozeta Tili, ka kryer shkelje shumë të rënda, të parashikuara në nenet 57, pika 2 si dhe 58, pika a) të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, ndaj ka marrë ndaj saj masën disiplinore “Largimi nga shërbimi civil”.

Paditësja duke mos qenë dakord me vendimin e largimit nga detyra i është drejtuar gjykatës

me kërkesë padi, me objekt "Shfuqizimin e vendimit nr. 1086, datë 23.06.2014 të Komisionit Disiplinor të DPT, si të pabazuar në ligj dhe në prova si dhe zgjidhjen e pasojave.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, me vendimin nr. 7795, datë 26.12.2014, ka vendosur:

- Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 1086, datë 23.06.2014 të Komisionit të Disiplinës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.
- Detyrimin e palës së paditur Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të rikthejë paditësen [REDAKTUAR] në detyrën Inspektore e Dytë në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë.
- Detyrimin e palëve të paditur t'i paguajnë paditëses [REDAKTUAR] pagën e plotë që nga dita e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare dhe në vijim.

Mbi ankimin e DPT-së çështja është marrë në shqyrtim nga një kolegji i Gjykatës Administrative të Apelit, i cili me vendimin nr. 926, datë 02.03.2017, vendosi të ndryshojë vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke rrëzuar si të pabazuar padinë e paditëses, [REDAKTUAR]

Vendimi i largimit nga shërbimi civil, rezulton të jetë dhënë gjatë periudhës që paditësja ka qenë me paaftësi të përkohshme në punë, kjo sipas të dhënave të raportit mjekësor për periudhat kohore:

- në datat 27.05.2014 – 30.05.2014, sipas të dhënave nr. 2978 regj.;
- në datat 29.05.2014 – 12.06.2014, sipas të dhënave nr. 2555 regj.;
- në datat 12.06.2014 – 26.06.2014, sipas të dhënave nr. 2555 regj.;
- në datat 26.06.2014 – 10.07.2014, sipas të dhënave nr. 2555 regj.

Paditësja për shkak të kushteve të saj shëndetësore ka qenë e shtruar në Spitalin Amerikan, në Tiranë për periudhën kohore nga data 29.02.2012 deri në datën 07.03.2012, kjo sipas të dhënave të dokumentit "Epikrizë dalje", i cili mban numrin e kartelës klinike 112171, të pacientes [REDAKTUAR]. Nga përmbajtja e së cilës rezulton së me datë 29.02.2011 është kryer një intervent mjekësor (operacion).

Paditësja, paralelisht me gjykimin e padisë së saj për largimin nga shërbimi civil, i është drejtuar me Ankesën nr. 66, datë 14.07.2014, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ("KMD"), duke pretenduar diskriminim për kategoritë, bindje politike dhe për shkak të gjendjes shëndetësore, nga ana e DRT Tiranë.

Drejtori i DRT Tiranë, me shkresën nr. 48848/1 prot, datë 30.07.2014, me titull "Kthim përgjigje KMD", i bën me dije këtij institucioni se:

"[...] Znj. [REDAKTUAR] është larguar nga shërbimi civil me vendim të Komisionit Disiplinor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, i cili është organi i emërtesës dhe i vendimmarrjes në lidhje me largimin nga shërbimi civil të punonjësve të Administratës Tatimore. Çdo propozim në lidhje me largimin nga shërbimi civil shqyrtohet nga Komisioni Disiplinor i ngritur për të vlerësuar masat disiplinore apo propozimet për largim ndaj punonjësve të Administratës Tatimore. Kjo kategori e punonjësve gëzon të drejtën e dëgjimit, dhënies së argumenteve, paraqitjes së observacioneve dhe të gjitha provave shkresore që vërtetojnë pretendimet e tyre në lidhje me shkeljet disiplinore të konstatuara.

...Në lidhje me pretendimin e ankueses për mos pajisjen me kartën (badge) për vitin 2014, sqarohet se ky veprim nuk është i qëllimshëm, pasi kartat për vitin 2014 janë dhënë vetëm për punonjësit e rinj dhe të sapoemëruar në detyrë. Ju bëjmë me dije se as punonjësit aktualë, të cilët e kanë pasur një kartë të mëparshme, nuk janë pajisur me kartë të re, dhe ky fakt nuk mund të konsiderohet si diskriminues për znj. [REDAKTUAR]. Çdo propozim në lidhje me largimin nga shërbimi civil ka ardhur vetëm si pasojë e mospërmbushjes së detyrave funksionale të znj. [REDAKTUAR].

KMD-ja, në zbatim të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i cili në nenin 33, pika 8, e tij, përcakton: "...Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar", me datë 14.10.2014, vendosi të realizojë një seancë dëgjimore mes palëve dhe bëri njoftimin me shkresën me nr. 670/3 Prot, datë 06.10.2014.

Seanca u zhvillua me praninë e të dy palëve. Nga përmbajtja e procesverbalit të mbajtur, rezulton se, përfaqësuesit e DRT Tiranë, mohuan që zonja [REDAKTUAR] të jetë diskriminuar për shkak të bindjeve politike dhe se procedurat për marrjen e masave disiplinore ndaj saj kanë qenë të rregullta nga ana ligjore. Ndërsa ankuesja ka ngritur pretendimin se, asaj qëllimisht dhe në mënyrë të pajustificuar i janë bërë tre propozime të njëpasnjëshme për dhënie masash disiplinore, çka tregon edhe tendencën e DRT Tiranë për diskriminim ndaj saj. Znj. [REDAKTUAR] thekson faktin se për shkak të gjendjes së saj shëndetësore, ajo nuk ka patur mundësi të paraqesë observacionet e saj përpara Komisionit Disiplinor dhe këtë pretendim e mbështet me Raportin mjeko-ligjor. Ajo nuk është njoftuar më për t'u paraqitur pranë këtij komisioni, dhe vendimi për largimin e saj nga puna është marrë ndërkohë që ajo ka qenë me raport mjeko-ligjor.

Personi i tretë, KMD, në bazë të nenit 12, pika 1, germat c) dhe ç), nenit 13, pika 1, germa a), nenit 32, germa c), si dhe nenit 33, pikat 10, 11 dhe 12, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", me vendimin nr. 11, datë 23.01.2015, ka vendosur:

"Konstatimin e mosdiskriminimit për shkak të bindjeve politike, të znj. [REDAKTUAR] nga ana e DRT Tiranë.

Konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë, për shkak të gjendjes shëndetësore të znj. [REDAKTUAR] nga ana e DRT Tiranë.

Në referim të pikës 2, të këtij vendimi, i rekomandohet subjektit ankues që mund të kërkojë dëmshpërblim sipas parashikimeve ligjore, gjyqësisht, bazuar në: nenin 36, pika 1, nenin 37, pika 1, dhe në nenin 38 të ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

KMD-ja, në arritjen e përfundimeve të mësipërme, ka arsyetuar si më poshtë:

"Subjekti ankues pretendon se një nga shkaqet e diskriminimit të saj, nga ana e DRTT, janë edhe bindjet e saj politike, pasi ajo mendon se Drejtori, z. [REDAKTUAR] ka krijuar përshtypjen se ajo ka bindje të ndryshme politike nga vetë ai. Shkak mund të jetë edhe shoqërimi i saj me persona të cilët i kanë shprehur haptas bindjet e tyre të djathta politike. Mirëpo znj. [REDAKTUAR]

a) nuk ka paraqitur ndonjë dokument që të tregojë angazhimin e saj politik, si psh. Kartë anëtarësie në një Parti politike.

b) nuk solli asnjë fakt që të krijonte bindjen se drejtori mund të kishte dijeni për bindjet e saj politike.

Për këtë shkak, pretendimi i saj se diskriminohet për shkak të bindjeve politike nuk është i mbështetur në një dokument shkresor dhe nuk është i provuar.

2. Lidhur me pretendimin e diskriminimit për shkak të gjendjes shëndetësore.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, vërtetohet që gjendja shëndetësore e ankueses është rënduar gjatë periudhës së marrjes së masave disiplinore ndaj saj, pasi raportet mjekësore të paraqitura e vërtetojnë atë. Ato datojnë në periudhën nga 27.05.2014 - 10.07.2014. Që para kësaj periudhe zonja rezulton të jetë operuar e trajtuar për një periudhë të gjatë kohore për diagnozën "Rektorogji post rezeksion rektosignoiden".

Marrja e masave disiplinore ndaj saj ka vijuar si më poshtë:

Me shkresën me nr. 3247, datë 21.01.2014 "Propozim për fillim ecurie disiplinore" të DRTT, është propozuar marrja e masës disiplinore "Vërejtje me paralajmërim".

Me shkresën me nr. 3684, datë 23.01.2014 "Propozim për fillim ecurie disiplinore" të DRTT, është propozuar marrja e masës disiplinore "Largim nga shërbimi civil".

Më datë 26.02.2014 del Vendimi i Komisionit Disiplinor për masën e parë "Vërejtje me shkrim". Me datë 23.05.2014 i jepet masa e dytë disiplinore për largim nga puna.

Me datë 27.05.2014 znj. Tili kishte për t'u paraqitur në Komisionin Disiplinor për masën e dytë disiplinore. Ankuesja nuk është paraqitur në Komision, pasi nuk është ndjerë mirë nga ana shëndetësore dhe ka paraqitur një Raport-mjekësor. Ndërkohë që ishte me Raport- mjekësor ka dalë Vendimi nr. 1068, datë 23.06.2014 i Komisionit Disiplinor të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë, në të cilin është vendosur marrja e masës disiplinore "Largim nga shërbimi civil". Me shkresën me nr. 43769/1 prot, datë 03.07.2014, i është komunikuar lirimi nga detyra.

(...)

Ligji "Për mbrojtjen nga diskriminimi" ofron mbrojtje nga sjelljet diskriminuese në fushën e punësimit. Konkretisht, në nenin 12, pika 1, germa b) parashikon: "Ndalohej diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1) të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: e) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës".

Në kuadër të zbatimit të këtij ligji, Komisioneri, konstaton se subjekti ankues është diskriminuar për shkak të gjendjes së saj shëndetësore, gjatë procesit disiplinor të ndërmarre ndaj saj, si dhe lidhur me largimin e saj nga puna. Komisioneri sheh si tendencioze dhe të qëllimshme marrjen e njëpasnjëshme të masave disiplinore ndaj znj. [REDAKTUAR] (Pa u shprehur Komisioni Disiplinor për masën e parë, i propozohet masa e dytë disiplinore)

Neni 41, pika 1) e Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", parashikon se: "Nëpunësi civil ka të drejtën të informohet për fillimin e çdo procedimi administrativ dhe për çdo vendim përfundimtar që ka të bëjë me marrëdhëniet e tij të shërbimit civil".

Po ashtu, neni 59, pika 7 e po këtij ligji, shpreh se: "...procedimi administrativ disiplinor garanton të drejtën e nëpunësit për t'u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit, për t'u informuar lidhur me shkeljen faktike të pretenduar dhe provat për kryerjen e saj, të drejtën për t'u dëgjuar, për të paraqitur prova, për mbrojtje juridike dhe të drejtën për t'u asistuar, si dhe të drejtën për t'u ankuar ndaj vendimit përfundimtar. Nëpunësi civil mund të asistohet gjatë procedimit disiplinor nga një përfaqësues i sindikatës ku bën pjesë, një avokat apo një përfaqësues i nëpunësve civilë të institucionit, nëse nuk është anëtar i një sindikate".

Referuar sa më sipër, nga ana e DPT Tiranë, kemi moszbatim dhe shkelje të qëllimshme të këtyre parashikimeve ligjore, pasi:

a) Më datë 27.05.2014, subjekti ankues ka paraqitur një raport mjeko-ligjor për paaftësi të përkohshme në punë, dhe nga data 27.05.2014 dhe deri më datë 10.07.2014, nuk është paraqitur më në punë për arsye shëndetësore, pasi zonja ka qenë e shtruar në spital për kurim. Pala ndaj së cilës ajo ankohet, ka qenë në dijeni për situatën e saj të rënduar shëndetësore, pasi ajo ka depozituar Raportin mjeko-ligjor pranë DRT Tiranë.

b) Po ashtu, ankueses i është bërë vetëm një lajmërim për t'u paraqitur në KD, më datë 27.05.2014, datë kur ka qenë me raport mjekësor, dhe nuk ka patur më tej asnjë lajmërim të dytë zyrtar, për t'u paraqitur në KD, vetë apo me përfaqësues ligjor...

c) Komisioni Disiplinor ka marrë vendimin pa bërë njoftimet përkatëse sipas ligjit, edhe pse ka qenë në dijeni për Raportet-mjekësore të znj. [REDAKTUAR]. Vendimi është marrë në mungesë pa iu dhënë mundësia që ajo të ngrejë pretendimet në KD, për shkeljet e pretenduara nga DRT Tiranë. Për sa kohë ankuesja ka provuar me raporte mjekësore se ishte e paaftë të merrte pjesë në mbledhjet e Komisionit, pasi kishte shkak të arsyeshem për mospjesëmarrje, KD nuk mund të vazhdonte procedurën e vendimmarrjes në mungesë të saj. (Referuar nenit 41, pika 1, dhe nenit 59, pika 7, e Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil")

Vendimi nr. 1068, datë 23.06.2014, i Komisionit Disiplinor i DPT-së, për largimin nga shërbimi civil, i është komunikuar znj. [REDAKTUAR] në datë 10.07.2014, dita kur është kthyer në punë nga raporti spitalor.

ç) Në shkresën me nr. 12486 prot, datë 22.05.2014 znj. [REDAKTUAR] është njoftuar për fillimin e ecurisë disiplinore ndaj saj për shkelje të rëndë të detyrës funksionale, dhe në këtë shkresë i bëhet me dije se nuk ka përmbushur kërkesat e Urdhrit të punës nr. 21540, datë 10.04.2014, ndërkohë që në cilësinë e provës është paraqitur Urdhri i punës nr. 12540, datë 10.03.2014, i cili ka shërbyer dhe si bazë për fillimin, zhvillimin e ecurisë disiplinore dhe ndëshkimin e ankueses me masën disiplinore "Largim nga shërbimi civil". Nga ana tjetër, jemi në rrethanat kur shkresa së cilës i referohet marrja e vendimit për largim nga shërbimi civil: të KD, është e gabuar në datë dhe në përmbajtje, çka vërteton vendimin arbitrar të marrë në shkelje të ligjit, dhe tendencën për largim nga puna për një motivacion tjetër dhe jo atë të cituar në këtë vendim. Fakti që kjo shkresë nuk ka të bëjë fare me motivacionin për të cilin ankuesja është larguar nga shërbimi civil dhe është tërësisht e pabazuar, bën që Komisioneri të ketë bindjen se në këtë rast ka një tendencë të fshehur për largimin e znj. [REDAKTUAR]. Kjo për faktin se, në cilësinë e provës, nga ana e DRT Tiranë është paraqitur shkresa me përmbajtjen e gabuar, e cila ka shërbyer si bazë për fillimin, zhvillimin e ecurisë disiplinore dhe ndëshkimin e ankueses me masën disiplinore "Largim nga shërbimi civil". Në këtë shkresë, nga DRT Tiranë citohet si shkak mospërmbushja e detyrave të përcaktuara në Urdhrin e punës nr. 12540, datë 10.03.2014, ndërkohë që në përmbajtjen e vet ky Urdhër i referohet mospërputhjes të të dhënave të formularit ESIG 027/a me të dhënat e sistemit TAX CRM, çka nuk i referohet znj. [REDAKTUAR] pasi përditësimi i këtyre të dhënave nuk përbën asnjë detyrë funksionale të Inspektorit të verifikimit në terren.

E gjithë dinamika e ngjarjeve, duke filluar që nga marrja e masave disiplinore dhe mungesa e transparencës në gjithë këtë procedim administrativ, bën që ankueses t'i mohohet e drejta e aksesit si palë, për t'u informuar dhe për t'u dëgjuar. Pala ndaj së cilës, znj. [REDAKTUAR] ankohet, ka patur dijeni për gjendjen e saj shëndetësore, përmes raporteve mjekësore, dhe megjithatë ka vazhduar procedimin administrativ pa i bërë njoftimin e dytë, që ajo të mund të përfaqësohej me përfaqësues ligjor. Në këtë mënyrë është shkelur haptazi parimi i garantimit të barazisë së armëve në komision. Pra, Komisioni Disiplinor ka marrë vendim, duke patur dijeni për gjendjen shëndetësore të ankueses dhe pa i dhënë mundësinë asaj (ose përfaqësuesit të saj ligjor) të parashtrijë dhe argumentojë pretendimet e saj.

Në formularin e ankesës znj. [REDAKTUAR] kërkon dëmshpërblim dhe jo rikthim në vendin e punës. Komisioneri për mbrojtjen nga Diskriminimi, në kompetencat që i jep Ligji "Për mbrojtjen nga diskriminimi nuk ka tagër për të dhënë dëmshpërblim, por neni 34, pika 1, e ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi", përcakton se: "Çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim për një nga shkaqet e përmendura në nenin 1, të këtij ligji, mund të paraqesin kërkesëpadi përpara gjykatës kompetente sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile për dëmshpërblim sipas ligjit ose, sipas rastit, të kryejnë kallëzimi përpara organeve kompetente për ndjekje penale". Në nenin 37, pika 1 e këtij ligji, parashikohet se: "Vendimi i Gjykatës cakton dëmshpërblim nëse gjykata vendos që ka shkelje të këtij ligji, duke përfshirë edhe një afat kohor për kryerjen e zhdëmtimit".

Po kështu, neni 38 i po këtij ligji parashikon se: "Dëmshpërblimi përfshin, ndër të tjera, ndreqjen e shkeljeve ligjore dhe të pasojave të tyre përmes kthimit në gjendjen e mëparshme, kompensimin e dukur për dëmet pasurore dhe jopasurore, ose përmes masave të tjera të përshtatshme".

a) Pretendimet e paditëses, [REDAKTUAR]

1
Paditësja, [REDAKTUAR] gjatë gjykimit në shkallë të parë, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se, ka qenë në marrëdhënie pune me palën e paditur. Që prej disa vitesh ajo vuan nga një sëmundje e rëndë për kurimin e të cilës ka bërë dhe një ndërhyrje kirurgjikale dhe vijon të trajtohet me medikamente.

Ndaj paditëses pala e paditur ka filluar ecurinë disiplinore kur nuk ekzistonte thyerja e disiplinës. Mbi ecuritë disiplinore tendencioze nga ana e palës së paditur i është drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

KMD-ja, ka kryer hetimin administrativ mbi diskriminimin shëndetësor që ka ardhur nga pala e paditur DRT Tiranë. Për këtë fakt, KMD-ja ka marrë vendimin nr. 11, datë 23/01/2015, ku ka vendosur konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë, për shkak të gjendjes shëndetësore të paditëses.

Paditësja ka legjitimim aktiv, duke qenë se i janë cenuar nga pala e paditur interesat pasurore e jopasurore, duke i shkaktuar dëm i cili vjen çdo ditë duke u shtuar. Pala e paditur, DRT Tiranë, ka legjitimim pasiv, duke qenë se është përcaktuar si diskriminuesi i drejtpërdrejtë për shkak të gjendjes shëndetësore, nga pala e tretë KMD. DPT-ja, ka legjitimim pasiv duke qenë se ka vlerësuar ecurinë disiplinore dhe ka marrë masat disiplinore kur nuk ekzistonin thyerje disiplinore dhe në fund ka nxjerrë urdhrin për largim nga detyra dhe përjashtimin nga shërbimi civil. Personi i tretë, KMD, ka interesa, sepse ka kryer hetimin administrativ në lidhje me diskriminimin.

Paditësja e ka shteruar rekursin administrativ duke iu drejtuar DPT-së si organi më i lartë administrativ dhe DRT Tiranë, ku i është kthyer përgjigje negative.

Bazuar në ligjin nr. 8510/1999 "Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore", paditësja ka kërkuar të përgjigjen civilisht e solidarisht DRT Tiranë e DPT për dëmin e ardhur paditëses dhe të përcaktuar në objektin e padisë.

Veprimet dhe mosveprimet e palës së paditur, DRT Tiranë e DPT, kanë shkaktuar dëm të rëndë mbi shëndetin tim duke përkeqësuar situatën e rënde shëndetësore që po kaloja. Dëmi është akoma më i madh, sepse pasojat e shëndetit pothuajse janë të pariparueshme, por ato rëndohen për çdo ditë, pasi paditësja ndjehet e braktisur. Paditësja vijon të kurohet dhe familjarët i qëndrojnë në përkujdesje të vazhdueshme.

b) Prapësimet e palës së paditur, DRT Tiranë:

Pala e paditur, DRT Tiranë, duke kërkuar rrëzimin e padisë, ka prapësuar se:

Paditësja ka qenë në marrëdhënie pune pranë DRT Tiranë dhe përmes një procedure administrative disiplinore është larguar nga shërbimi civil. Largimi i saj nga detyra është bërë konflikt gjyqësor dhe përfundimisht Gjykata Administrative e Apelit e ka rrëzuar padinë e paditëses, [REDACTED]

Nuk ka asnjë provë me shkresë që të provojë se paditëses i është shkaktuar dëm moral, biologjik dhe ekzistencial si rezultat i drejtpërdrejtë i veprimeve të palës së paditur.

Konkluzionet e ekspertit janë të pabazuara në asnjë provë me shkresë. Sëmundja e paditëses është shfaqur para largimit të saj nga puna e për rrjedhojë nuk mund të mbajmë përgjegjësi për dëmet shëndetësore sa kohë që nuk provohet shkaktari i saj.

Nuk provohet asnjë lidhje mes veprimeve të administratës me dëmin pasuror dhe jopasuror. Megjithëse paditëses mund t'i jetë shkaktuar ankth dhe mundim shpirtëror si rezultat i largimit nga puna, nuk mund të akordohet një shpërblim duke mos ditur se sa është masa e ankthit të shkaktuar. Pra nuk provohet lidhja shkakësore dhe as përmasa e dëmit të pretenduar, pasi eksperti i referohet praktikave të ngjashme në fushën e sigurimeve.

c) Pretendimet e personit të tretë, KMD:

nr. 10221/2012 "Për mbrojtjen nga Personi i tretë, KMD, duke kërkuar pranimin e padisë, ka pretenduar se, në referencë të ligjit "diskriminimi", dëmshpërblimi përfshin, ndër të tjera, ndreqjen e shkeljeve ligjore dhe të pasojave të tyre përmes kthimit në gjendjen e mëparshme, kompensimin e duhur për dëmet pasurore si dhe jopasurore, ose përmes masave të tjera të përshtatshme.

Mbi këtë bazë ligjore, pasi është konstatuar diskriminim, i është rekomanduar subjektit që mund të kërkojë dëmshpërblim sipas parashikimeve ligjore, gjyqësisht, bazuar në nenin 36, pika 1, nenin 37, pika 1, dhe në nenin 38 të ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

II. Arsytimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë:

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë (gjykata e shkallës së parë), me vendimin Nr. 4501 (80-2015-2791), datë 17.09.2015, ka vendosur të pranojë padinë, si të bazuar në prova dhe në ligj.

Në pjesën relevante të vendimit, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar, si vijon:

“[...] Dëmi pasuror, i pretenduar nga paditësja në rastin konkret nuk është evident, për shkak se siç dhe vetë paditësja pretendon në kërkesëpadi ajo është diagnostikuar me sëmundje të rëndë dhe ka bërë ndërhyrje kirurgjikale që në vitin 2011, pra rreth tre vite para se të merrej masa disiplinore. Nuk u administrua asnjë provë e cila të provojë se shëndeti i paditëses është rënduar si rezultat i drejtpërdrejtë i procedurave administrative disiplinore. Vetëm fakti i marrjes së raporteve mjekësore në periudhën që zhvillohej procedura nuk janë tregues i lidhjes së drejtpërdrejtë mes rëndimit të shëndetit dhe procedurës disiplinore. Nga vetë natyra dhe graviteti i sëmundjes që i ka zgjatur disa vite paditëses nuk mund të dilet në konkluzione që nuk janë kategorike dhe aq më pak shkencore se, shëndeti i paditëses është rënduar si rezultat i drejtpërdrejtë i ecurisë disiplinore.

b) Faji është një ndër elementët e domosdoshëm për të pasur vend për përgjegjësi jashtëkontraktore të organit të administratës publike. Në rastin konkret elementi faj i palës paditëse, u evidentua nga vendimi i organit kompetent që është KMD, i cili përmes një vendimi që tashmë ka marrë formë të prerë i paankimuar nga palët ka konstatuar diskriminim për shkak të shëndetit.

c) Paligjshmëria e veprimit apo e mosveprimit të organit administrativ është kriteri tjetër, i cili është trajtuar nga Gjykata Administrative, përmes vendimit nr. 7795, datë 26.12.2014. Në këtë vendim i cili nuk është i formës së prerë pasi është ankimuar në Gjykatën e Apelit Administrativ, pasi është konstatuar si e paligjshme procedura e largimit të paditëses nga detyra është disponuar kthimi në të njëjtin pozicion pune dhe dhënia e pagës deri në ekzekutimin e vendimit.

Nga ana tjetër Komisioneri me vendim të formës së prerë ka konstatuar diskriminim të paditëses për shkak të shëndetit. Kjo formë e diskriminimit do të trajtohet në vijim dhe shpërblimi po ashtu do të trajtohet në referencë të vendimit të Komisionerit si dhe të ligjit special 10221/2010, nenet 36 dhe 37. Pra shpërblimi në këtë rast do të jetë i natyrës së shpërblimit për dëm moral dhe ekzistencial, si pasojë e drejtpërdrejtë diskriminimit të konstatuar nga Komisioneri.

d) Në zbatim të nenit 609 të Kodit Civil për pranimin e përgjegjësisë civile jashtëkontraktore, duhet të vërtetohet lidhja shkakësore materiale ndërmjet sjelljes (veprimit a mosveprimit) së paligjshme e me faj dhe dëmit të shkaktuar. Lidhja shkakësore mes veprimit dhe mosveprimit të paligjshëm të organit të administratës/palës së paditur dhe pasojës së ardhur, është elementi i fundit dhe ndoshta më i rëndësishmi për t'u marrë në analizë, aq më tepër në kushtet kur paditësja rezulton që të ketë qenë e diagnostikuar me sëmundje të rëndë dhe për të cilën ka bërë dhe ndërhyrje kirurgjikale që në vitin 2011.

...Në rastin konkret objekt gjykimi nga tërësia e provave shkresore të administruara në gjykim, nuk rezultojnë të provuara në mënyrë kumulative që të gjitha kushtet ligjore të sipërcituara e të domosdoshëm pa të cilat nuk ka vend për përgjegjësi jashtëkontraktore. Konkretisht ka elemente të cilët nuk rezultojnë aspak të provuar, janë lidhja shkakësore e drejtpërdrejtë mes veprimit apo mosveprimit të paligjshëm (i cili dhe ai është në proces të të

provuarit pasi vendimi gjyqësor nuk ka marrë formë të prerë) dhe pasojave të dëmshme. Mungesa e lidhjes shkakësore të drejtpërdrejtë e bën të pamundur që palës së paditur t'i ngarkohet një detyrim për dëm pasuror, i cili në këtë rast do të trajtohet pjesërisht dhe përmes evidentimit të diferencave mes dëmit që mund të jetë shkaktuar realisht me shumën e përfituar nga vendimi gjyqësor në rast se vendimi merr formë të prerë përmes konfirmimit në Gjykatës së Apelit Administrativ.

Sa i përket dëmit jopasuror gjykata merr në konsideratë dy akte. Së pari, vendimin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi nr. 11, datë 22.01.2015, i cili është i formës së prerë për shkak së nuk është ankimuar në gjykatë, si dhe [së dyti] aktin e ekspertimit të administruar në gjykim. Konkretisht nga vendimi i KMD-së, i formës së prerë, është i provuar fakti, se paditësja është diskriminuar nga pala e paditur për shkak të gjendjes shëndetësore. Dëmi i ardhur si rezultat i diskriminimit për shkak të gjendjes shëndetësore është i natyrës së dëmit moral, pasi në vetë pjesën arsyetuese të vendimit të Komisionerit argumentohet se, diskriminimi ka ardhur kryesisht si rezultat i mosveprimeve të palës së paditur. Diskriminimi i konstatuar nga ana e Komisionerit ka si pasojë të drejtpërdrejtë që nuk ka nevojë të vërtetohet dëmin jopasuror të natyrës së dëmit moral. Ndërsa dëmin pasuror paditësi duhet ta provojë përmes akteve shkresore që në këtë gjykim munguan. Në gjykim u administrua akti i ekspertimit përmes të cilit është bërë përlllogaritja e vlerës së dëmit moral të shkaktuar paditëses.

Së treti: Sa i përket llojit, mënyrës së përlllogaritjes së vlerës së dëmit të pretenduar, Gjykata, mbi bazën e përfundimeve të mësipërme, si dhe në referencë të vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 12, datë 14.09.2007, mbi bazën e kërkesës së palës paditëse disponoi në marrjen e provës me ekspert të fushës së vlerësimit të dëmeve, i licencuar nga organet kompetente (AMF). Rezultatet e aktit të ekspertimit u debatuan në seancë gjyqësore nga palët ndërgjyqëse dhe do të analizohen nga gjykata në vijim të arsyetimit.

...

Në gjykim, paditësja, në mbështetje të neneve 641, 646, 647 të K.Civil, ka kërkuar të dëmshpërblehet për dëmin pasuror në formën e cenimit të pasurisë së saj dhe rikthimin në gjendjen në të cilën ndodhej para diskriminimit. Lidhur me sa më sipër gjykata siç dhe arsyetoi në pikën më lart çmon së dëmi pasuror jo vetëm që nuk u provua në këtë gjykim por dhe nga ana tjetër në çdo rast do të duhej të ishte diferencë mes dëmshpërblimit të akorduar nga gjykata që ka në gjykim ligjshmërinë e aktit administrativ të largimit nga shërbimi civil me atë të dëmit të pretenduar se i është shkaktuar. Po ashtu sa i përket këtij kërkimi siç u parashtrua më sipër mungon dhe elementi lidhje shkakësore mes veprimit/mosveprimit dhe pasojave të pretenduara se kanë ardhur.

... Paditësja në kërkimet e saj të parashtruara në kërkesëpadi, kërkon dëm jopasuror, sipas tre figurave të pavarura të tij, dëm biologjik (dëmtim i shëndetit), dëm moral (në formën e dhimbjeve dhe vuajtjeve shpirtërore) dhe dëm ekzistencial (ose dëmi mbi cilësinë e jetës).

...Sa i përket dëmit moral gjykata çmon se është i mjaftueshëm konstatimi i bërë nga ana e KMD sipas të cilit paditëses i është shkaktuar diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore. Si rezultat i diskriminimit për shkak të gjendjes shëndetësore paditëses i është cenuar cilësia e

jetesës, si duke iu shkaktuar dhimbje dhe vuajtje shpirtërore apo gjendje ankthi e mundimi shpirtëror që rrjedh si pasojë e diskriminimit.

Në përcaktimin e vlerës së dëmit, gjykata i kërkoi ekspertit që si metodikë të përllogaritjes së vlerës së dëmit të mbahet parasysh vendimi unifikues i sipërcituar i Kolegjeve të Bashkuara të Gj.Lartë. Nga ana e ekspertit sa i përket vlerave të dëmit jopasuror, moral dhe ekzistencial u dol me vlera minimale dhe maksimale. Gjykata nisur nga natyra e veprimeve diskriminuese si dhe nga vlera e dëmshpërblimit, çmoi të përzgjedhë vlerën minimale sipas përllogaritjes së ekspertit 250.000 lekë për dëmin moral (shih aktin e ekspertimit fq. 9 dhe 10).

iii) Përsa përket kërkimit të tretë të paditëses për dëm ekzistencial, kjo figurë dëmi është parashikuar shprehimisht në vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 12/2007. ...Sipas vendimit të sipërcituar, dëmi ekzistencial, si shfaqje e jashtme e cenimit të interesave të ligjshëm lidhur me cilësinë e jetës, është objektivisht i vërtetueshëm dhe nuk mund të provohet vetëm me anë të prezumimeve të thjeshta. Kolegjet e Bashkuara nënvizojnë në veçanti, në rastet e vdekjes apo dëmtimit të rëndë të shëndetit të të afërmit, për caktimin e masës së dëmshpërblimit ekzistencial mbahen parasysh edhe afërsia gjinore, përbërja dhe gjendja e bashkëjetesës në familje etj. Në referencë të akteve të mësipërme si dhe të aktit të ekspertimit gjykata çmoi të caktojë si dëmshpërblim për dëm ekzistencial shumën 250.000 lekë (shih aktin e ekspertimit).

Përfundimisht, Gjykata, pasi e gjen të bazuar në ligj dhe në prova vlerëson se padia për arsyet e cituara më sipër duhet që të pranohet vetëm pjesërisht duke ngarkuar palën e paditur me detyrimin për të shpërblyer dëmin ekzistencial dhe moral të shkaktuar si rezultat i diskriminimit për shkak të gjendjes shëndetësore, palës paditëse sipas vlerave të përllogaritura në aktin e ekspertimit.”

Vendimi përfundimtar i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar nga paditësja, [REDACTED] dhe pala e paditur, DRT Tiranë. Paditësja ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe pranimin e plotë të padisë, ndërsa pala e paditur, ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e padisë, për shkaqet që u pasqyruan në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

III. Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit:

Për të konkluduar lidhur me pretendimet e ngritura në ankimet respektive, Gjykata Administrative e Apelit (më poshtë referuar si “Gjykata e Apelit”/“kolegji”) vlerëson të marrë, së pari, në shqyrtim bazën ligjore që ajo referohet në zgjidhjen e konfliktit të parashtruar për gjykim.

Lidhur me detyrimin për shpërblimin e dëmit, në nenin 608 paragrafi i parë të Kodit Civil, është sanksionuar se: “Personi që, në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shkakton tjetrit një dëm në personin ose në pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar”.

Ndërsa në nenin 1 të ligjit nr. 8510, datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”, i cili është ligji që rregullon çështjet e përgjegjësisë jashtëkontraktore që kanë organet e administratës shtetërore, në ato raste kur i kanë shkaktuar

personave fizike a juridike, private, vendas a të huaj dëme pasurore dhe jopasurore jashtëkontraktore, është sanksionuar se: “Organet e administratës shtetërore përgjigjen për dëmet pasurore dhe jopasurore jashtëkontraktore, që u shkaktajnë personave fizike a juridike, private, vendas a të huaj”.

Në analizë të rrethanave faktike të çështjes, të dispozitave të përmendura si më sipër dhe të nenit 3 germa “a” të këtij ligji në të cilin përcaktohet se: “Organet e administratës shtetërore përgjigjen për dëmet që u shkaktajnë personave fizikë a juridikë privatë në rastet që vijojnë: a) kur kryejnë veprime a mosveprime të kundërligjshme...”, Gjykata vlerëson se për palën e paditur, DRT Tiranë dhe DPT, lind detyrimi për t’i shpërblyer paditëses dëmin e shkaktuar, vetëm në rast se provohet se me veprimet e tyre i ka shkaktuar dëm asaj.

Gjykata e Apelit vë në dukje se, përkufizimin e dëmit jashtëkontraktor dhe elementët e domosdoshëm për të pasur përgjegjësi jashtëkontraktore jepen në nenet 625 e 640 të Kodit Civil. Sipas këtyre dispozitave, çdo person që ka pësuar një dëm në shëndet apo në personalitetin e tij, ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit, i cili përbëhet nga humbja e pësuar dhe fitimi i munguar. Dëmi i pretenduar mund të përfitohet me vendim gjyqësor të formës së prerë, kur personi që pretendon një fakt të tillë provon ekzistencën e:

- a) dëmit, pasuror dhe jopasuror;
- b) fajit, si element i anës subjektive të organit shtetëror;
- c) paligjshmërisë së sjelljes së organit publik; dhe
- d) lidhjes shkakësore të drejtpërdrejtë mes veprimit apo mosveprimit me faj të organit të administratës dhe dëmit të ardhur.

Paditësja, edhe në ankimin e paraqitur, ka kërkuar krahas dëmit jopasuror, edhe dëmin pasuror që ajo pretendon se i është shkaktuar, nga heqja e padrejtë nga puna. Në gjykimin në shkallë të dytë u provua se, me vendim gjyqësor të formës së prerë padia e paditëses, [REDAKTUAR] për shfuqizimin e vendimit të Komisionit Disiplinor të DPT-së për largimin e saj nga shërbimi civil, është rrëzuar nga Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 926, datë 02.03.2017. Për pasojë, në vlerësimin e këtij kolegji, pretendimit të saj për ekzistencën e dëmit pasuror e jopasuror për heqjen nga puna i mungon kundërligjshmëria, ndaj kërkimet e saj në këtë pjesë duhen rrëzuar.

Paditësja ka kërkuar të dëmshpërblehet nga palët e paditura edhe për dëmin pasuror të pretenduar prej saj, si rrjedhojë e përkeqësimit të shëndetit nga largimi prej shërbimit civil. Ashtu siç drejt ka argumentuar gjykata e shkallës së parë, paditësja dështoi të provonte në gjykim ekzistencë të dëmit pasuror të shkaktuar nga veprimet diskriminuese kundrejt shëndetit të paditëses, të kryera nga pala e paditur.

Paditësja ka pranuar në gjykim se, është diagnostikuar me sëmundje të rëndë dhe ka bërë ndërhyrje kirurgjikale në vitin 2011, rreth tre vjet përpara para se të merrte masën disiplinore “Largim nga shërbimi civil”. Paditësja nuk paraqiti asnjë provë, në kuptim të nenit 12 të Kodit të Procedurës Civile, që të mbështeste pretendimin e saj, se i është rënduar shëndeti si rezultat i drejtpërdrejtë i procedurave administrative disiplinore.

Ky kolegji pajtohet me arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas të cilit: *“Vetëm fakti i marrjes së raporteve mjekësore në periudhën që zhvillohej procedura nuk janë tregues i lidhjes së drejtpërdrejtë mes rëndimit të shëndetit dhe procedurës disiplinore. Nga vetë natyra dhe graviteti i sëmundjes që i ka zgjatur disa vite paditëses nuk mund të dilet në konkluzione që nuk janë kategorike dhe aq më pak shkencore se, shëndeti i paditëses është rënduar si rezultat i drejtpërdrejtë i ecurisë disiplinore.”*

Faji është një ndër elementët e domosdoshëm për të pasur vend për përgjegjësi jashtëkontraktore të organit të administratës publike. Në rastin konkret elementi faj i palës së paditur, u evidentua nga vendimi i organit kompetent që është KMD, i cili përmes një vendimi që tashmë ka marrë formë të prerë i paankimuar nga palët ka konstatuar diskriminim për shkak të shëndetit.

Në referim të nenit 609 të Kodit Civil për pranimin e përgjegjesisë civile jashtëkontraktore, duhet të vërtetohet lidhja shkakësore materiale ndërmjet sjelljes (veprimit a mosveprimit) së paligjshme e me faj dhe dëmit të shkaktuar. Nëpërmjet lidhjes shkakësore materiale, vërtetohet se cili është personi përgjegjës (subjekti aktiv) dhe lidhja shkak-pasojë ndërmjet tre elementëve objektivë e subjektivë të faktit të paligjshëm (ngjarjes së dëmit), sjelljes së paligjshme (objektiv) e me faj (subjektiv) dhe pasojës së ardhur prej tyre, pra dëmtimit të një tjetri në personin a pasurinë e tij (objektiv).

Ndërsa, me lidhjen shkakësore/juridike vërtetohet lidhja shkak-pasojë ndërmjet faktit të paligjshëm në tërësinë e tij dhe cenimeve konkrete të pësura në të drejta dhe interesa të ligjshme, si të subjektit pasiv mbi të cilin ka vepruar direkt ky fakt i paligjshëm, ashtu edhe të personave të tjerë që rezultojnë të dëmtuar, si rrjedhojë e pasojave që pranohet se vijnë normalisht e zakonisht nga i njëjti fakt i paligjshëm, sipas parimeve të rregullshmërisë dhe efikasitetit të lidhjes shkakësore.

Në këtë kuptim, lidhja shkakësore nuk ndërpritet nëse pas vërtetimit të faktit të paligjshëm dhe pasojës “natyrale”, “materiale”, të ardhur prej tij, pra dëmtimit (cenimit) të interesave të ligjshme të subjektit pasiv nga sjellja e shkaktuesit të dëmit, vijnë e vërtetohen fakte të reja me pasoja të dëmshme, të cilat konsiderohen të lidhura e rrjedhojë direkte dhe e menjëhershme e të njëjtit fakt të paligjshëm, përderisa provohet që nëse ky nuk ndodhte, fakti i ri, i mëvonshëm, në vetvete, nuk mund të shkaktonte edhe ai të njëjtën pasojë të dëmshme.

Ndryshe nga sa pretendon në ankim pala e paditur, fakti i provuar i diskriminimit në aspektin shëndetësor të paditëses, i lind kësaj të fundit të drejtën për të kërkuar gjyqësisht pagimi në dëmit jopasuror të pësuar.

Ashtu siç u përmend më lart, fakti që paditëses [REDAKTUAR] i është shkaktuar dëm jopasuror u provua me vendimin e KMD-së. Dëmi i ardhur si rezultat i diskriminimit për shkak të gjendjes shëndetësore është i natyrës së dëmit moral, pasi në vetë pjesën arsyetuese të vendimit të Komisionerit argumentohet se, diskriminimi ka ardhur kryesisht si rezultat i mosveprimeve të palës së paditur.

Në gjykimin në shkallë të parë është marrë edhe prova me ekspert, ku është bërë përlllogaritja e vlerës së dëmit moral të shkaktuar paditëses.

Gjykata e Apelit konstaton se, dëmi jopasuror është parashikuar shprehimisht në nenin 625 të Kodit Civil, si një kategori e gjerë dhe gjithëpërfshirëse e dëmeve jashtëkontraktore, dhe që përfshin çdo lloj dëmi të pësuar nga cenimi i të drejtave dhe interesave jo pasurore që bëjnë pjesë në vlerat e njeriut dhe që nuk janë subjekt vlerësimi të drejtpërdrejt ekonomik në treg. Në thelbin e saj, kjo dispozitë njeh të drejtën e dëmshpërblimit për çdo lloj dëmi jopasuror jashtëkontraktor, i cili është “i ndryshëm nga ai pasuror”.

Paditësja në kërkimet e saj të parashtruara në ankim, kërkon dëm jopasuror, sipas tre figurave të pavarura të tij, dëm biologjik (dëmtim i shëndetit), dëm moral (në formën e dhimbjeve dhe vuajtjeve shpirtërore) dhe dëm ekzistencial (ose dëmi mbi cilësinë e jetës).

Dëmi shëndetësor (biologjik), konsiston në cenimin e integritetit fizik dhe psikik të njeriut për shkak të ngjarjes së rëndë, traumës së shkaktuar. Në lidhje me këtë lloj dëmi, në mungesë të provueshmërisë nga paditësja të cenimit të integritetit fizik e psikik, kërkitimi i saj nuk gjen mbështetje, ndaj është i papranueshëm.

Dëmi moral është shfaqja e brendshme, e përkohshme e turbullimit të padrejtë të gjendjes shpirtërore të njeriut, dhimbje dhe vuajtje shpirtërore apo gjendje ankthi a mundimi shpirtëror që rrjedh si pasojë e faktit të paligjshëm. Sipas Vendimit Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 12/2007, cilido që pëson cenime në sferën e shëndetit dhe të personalitetit të tij nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe me faj të një të treti ka të drejtë të kërkojë edhe dëmshpërblimin e dëmit moral të pësuar. Kjo e drejtë, në cilësinë e të dëmtuarit, i përket individualisht edhe secilit prej familjarëve të afërm të personit që është cenuar në shëndetin e tij nga fakti i paligjshëm, nëse vërtetohet lidhja e tyre e posaçme familjare, ndjesore dhe e bashkëjetesës.

Paditëses, si rezultat i diskriminimit për shkak të gjendjes shëndetësore, i është cenuar cilësia e jetesës, si duke iu shkaktuar dhimbje dhe vuajtje shpirtërore apo gjendje ankthi a mundimi shpirtëror që rrjedh si pasojë e diskriminimit.

Në përcaktimin e vlerës së dëmit, gjykata e shkallës së parë i kërkoi ekspertit që si metodikë të përlllogaritjes së vlerës së dëmit të mbahet parasysh vendimi unifikues i sipërcituar i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Nga ana e ekspertit sa i përket vlerave të dëmit jopasuror, moral dhe ekzistencial u dol me vlera minimale dhe maksimale.

Drejt ka konkluduar gjykata e shkallës së parë që, nisur nga natyra e veprimeve diskriminuese si dhe nga vlera e dëmshpërblimit, ka përzgjedhur vlerën minimale, sipas përlllogaritjes së ekspertit - 250,000 lekë për dëmin moral. Në caktimin e kësaj vlere, ndryshe nga sa pretendon në ankim paditësja, kihet në konsideratë se diskriminimi shëndetësor i paditëses ka ndodhur vetëm përgjatë zhvillimit të procedimit disiplinor ndaj saj nga palët e paditura, nëpërmjet mosmarrjes parasysh të pamundësisë së saj për shkak sëmundje për të marrë pjesë në këtë procedim..

Në lidhje me dëmin ekzistencial, ky i fundit është parashikuar shprehimisht në vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 12/2007. Kjo figurë autonome dëmi, që njihet ndryshe edhe si “dëm mbi cilësinë e jetës”, shkaktohet si rrjedhojë e cenimit të vlerave komplekse, të padhunueshme, të qenies njerëzore, të normalitetit dhe cilësisë së jetës së njeriut, të fushës së ndjenjave dhe të solidaritetit reciprok në kuadër të familjes, si dhe të shprehjes së lirë dhe të plotë të aftësive të qenies njerëzore për të zhvilluar personalitetin, për tu shfaqur dhe realizuar në shoqëri.

Dëmi ekzistencial, si shfaqje e jashtme e cenimit të interesave të ligjshëm lidhur me cilësinë e jetës, është objektivisht i vërtetueshëm dhe nuk mund të provohet vetëm me anë të prezumimeve të thjeshta. Në referencë të akteve të mësipërme, kur u provua dëmi jopasuror i shkaktuar paditëses për shkak të shëndetit të saj, kohën gjatë të cilës ajo iu nënshtrua këtij diskriminimi dhe të drejtat që iu cenuan asaj përgjatë procedimit disiplinor, në raport me shkeljet e paditëses, që me vendim gjyqësor u provuan se qëndrojnë, ky kolegji e gjen të drejtë përfundimin e gjykatës së shkallës së parë, që i ka caktuar shumën minimale të caktuar nga eksperti prej 250,000 lekësh, për dëmin ekzistencial të saj.

Në përfundim, Gjykata e Apelit, duke i gjetur të pabazuara shkaqet e ngritura në ankim nga paditësja dhe pala e paditur, sipas arsyetimit të mësipërm, vlerëson se vendimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë duhet të mbetet i pacenuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Administrative e Apelit, mbështetur në nenin 53, germa “a” të ligjit Nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S I:

- **Lënien në fuqi** të vendimit Nr. 4501 (80-2015-2791), datë 17.09.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
- **Kundër këtij vendimi** mund të ushtrohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, brenda 30 ditëve, duke filluar nga e nesërmja e komunikimit të këtij vendimi të arsyetuar.
- **U shpall në Tiranë, më 09.04.2019.**

A N Ë T A R
BARI SHYTI
(d.v.)

A N Ë T A R E
ALKELINA GAZIDEDJA
(d.v.)

K R Y E S U E S
AMARILDO LAÇI
(d.v.)

E njëjtë me origjinalin

Leonard Shyti
Amari Laci

